



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.276/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj-Rugova, dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë;03.02.2025, merr këtë,

VE N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, A.nr.276/2025, e datës;31.01.2025, e paraqitur kundër Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë;31.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik. Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendohet se me datë 29 janar 2025, kandidati për deputet nga lista e PDK-së, Dr. Pleurat Sejdiu, ka postuar një video në llogarinë e tij në facebook, me tekst shoqërues, të realizuar në hapësirat e brendshme të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, me konkretisht në Klinikën e Kardiologjisë Invazive. Ka theksuar se më këtë veprim i njëjti subjekt politik ka shkelur dispozitat e nenit 36, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjen e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: Fotografi dhe video me link që dëshmon veprimin në kundërshtim me LZP-në <https://fb.catch.ssEipkKuie>.

Më datë;01.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik, Partia Demokratike e Kosovës, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë;02.02.2025 në ora 15:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës;02.02.2025, subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka kërkuar që PZAP ankesën e ankuesit ta refuzojë si të pa bazuar për faktin se ankuesi në ankesën e tij ka tentuar që të vë në lajthim PZAP, duke pretenduar që fotografitë e publikuara nga ana e Dr. Pleurat Sejdiu janë realizuar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, respektivisht në Klinikën e Kardiologjisë Invazive ndërsa këto fotografi janë realizuar në ambientet e Spitalit Amerikan në Kosovë në të cilin Spital Dr. Pleurat Sejdiu është i angazhuar si ortoped. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë po ashtu deklaroi që më të pranuar ankesën subjekti Politik PDK ka kërkuar nga kandidati Pleurat Sejdiu të deklarohet lidhur me pretendimet ankimore dhe i njëjti përmes emailit ka konfirmuar se video incizimi është realizuar në ambientet e Spitalit Amerikan 1 në Prishtinë, institucion privat shëndetësor me datë 26 janar 2025, nga ora 13:00, diku rreth orës 14:15. Po ashtu përfaqësuesi i autorizuar i PDK-së Av. Faton Fetahu ka kontaktuar me Spitalin Amerikan përmes emailit nga i cili ka marrë konfirmim se video incizimi i publikuar nga Dr. Pleurat Sejdiu është realizuar në ambientet e brendshme të Spitalit Amerikan. Si provë parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka bashkangjitur: Komunikimin elektronik mes zyrtarëve të PDK-së dhe kandidatit për deputet Dr. Pleurat Sejdiu: Komunikimet elektronike në mes të përfaqësuesit të autorizuar të PDK-së dhe Spitalit Amerikan 1 në Prishtinë.

PZAP-i, pas vlerësimit të ankesës, pretendimeve nga përgjigja në ankesë, vëren se ankesa është e pa bazuar.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pa bazuar pasi që nga video dhe fotografitë të cilat paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesës, nuk mund të vërtetohet se nga ana e Subjektit Politik PDK, është bërë shkelje e nenit 36 paragrafi 1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se *“Personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”*

Nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehet se është realizuar një video e kandidatit për deputet Dr. Pleurat Sejdiu nga PDK, në rrjetin social facebook, por nuk është argumentuar në asnjë moment në mënyrë të qartë dhe bindëse se fotoja është realizuar në ambientet e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, konkretisht, në Klinikën e Kardiologjisë Invazive, ashtu siç pretendohet nga pala ankuese, kjo për faktin se video incizimi i dorëzuar si provë, në ankesë vërtetohet se video është realizuar në ambientet e Spitalit Amerikan në Kosovë, i cili është institucion privat shëndetësor. Po ashtu nga komunikimi elektronik i bërë nga përfaqësuesi i autorizuar i subjektit Politik të PDK-së me Spitalin Amerikan në Prishtinë, paneli vëren se Spitali Amerikan në përgjigjen e tij, e ka njoftuar të autorizuarin e PDK-së, se video incizimi i publikuar nga Dr. Pleurat Sejdiu është bërë në objektet e brendshme të Spitalit Amerikan.

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetojë se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të

Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar dhe si të tilla të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, lidhur me neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.276/2025, datë:03.02.2025

Kryesues i Panelit
Hajriz Hoti



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.